



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Buletini

Publikim
dymujor
Viti XI
Nr.64
Janar-Shkurt
2014

Nga mbledhja e Këshillit të Kryetarëve

Asociacioni i Komunave të Kosovës organizoi mbledhjen e Këshillit të Kryetarëve, të parën pas zgjedhjeve të fundit lokale.

Në këtë takim Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahim i elaboroi para Kryetarëve të Komunave fushëveprimtarinë e Asociacionit të Komunave të Kosovës, formën e funksionimit dhe skemën organizative. Poashtu para Kryetarëve të Komunave u prezantuan edhe format e lobimit dhe avokimit tek institucionet qendrore për mbrojtjen e interesave të pushtetit lokal në Kosovë.

Nga ana e tyre, Kryetarët e Komunave paraqiten këndvështrimet e tyre lidhur me përmbajtjen e lobimit dhe avokimit duke theksuar disa nga aktet ligjore ku ka nevojë për amendimin e tyre dhe disa nga sektorët komunal të cilët kanë

nevojë për përmirësime në mënyrë që cilësia e shërbimeve të komunës ndaj qytetarëve të rritet dhe fuqizohet.

Në këtë linjë, Kryetarët e Komunave kërkuan nga AKK-ja angazhim rreth organizimit të takimeve me ministra të linjës për të filluar procedurat për ndryshimin e ligjeve e sidomos atij mbi dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, prokurimit dhe shërbimit civil sepse menjëherë kanë hasur në vështirësi në implementimin e kompetencave të tyre. Poashtu kryetarët kanë kërkuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës organizimin e trajnimeve për drejtorët e rinj komunal.

Në mbledhjen e Këshillit të Kryetarëve u debatua edhe për organizimin e Kuvendit të Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave nga i cili pritet të dalin strukturat e reja udhëheqëse.



AKK-ja organizoi programin e trajnimeve për anëtarët e zgjedhur të Kuvendeve të Komunave

AKK-ja organizoi programin e trajnimeve për anëtarët e zgjedhur të Kuvendeve të Komunave

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) që nga 13 Janari 2014 deri me 14 Shkurt 2014 organizoi programin e financuar nga Agjencioni Zvicerian për Zhvillim (SDC) mbi **“Trajnimin e Anëtarëve të zgjedhur të Kuvendeve Komunale”**.

Ky program u implementua në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Këshilltarët Komunalë të cilët morën pjesë në këto trajnime u

pajisen me publikimin që përmbledh ligjet kryesore për dhe rreth pushtetit lokal në Republikën e Kosovës si dhe pas ligjerimeve në tema të caktuara patën mundësitë e bashkëbisedimit me prezantuesit e temave lidhur me aspekte të ndryshme të funksionimit të qeverijes lokale në vend dhe rastet e rajonit.

AKK-ja organizoi gjithsej 45 seanca trajnimi, ku u mbajtën pesë (5) takime regjionale për

secilën nga nëntë (9) fushat/temat lidhur me vetëqeverisjen lokale në Kosovë.

Vlen të ceket se kjo është hera e tretë me rradhë që pas zgjedhjeve lokale në Kosovë Asociacioni i Komunave të Kosovës ofron dhe organizon programin e trajnimeve në fushat kryesore të vetëqeverisjes lokale për anëtarët e zgjedhur të Kuvendeve të Komunave në Republikën e Kosovës.



Takimet trajnuese u organizuan nëpër qendrat regjionale të Kosovës:

Prishtinë (për komunat Prishtinë, Fushë Kosovë, Graçanicë, Obiliq, Podujevë, Lipjan dhe Shtime),

Prizren (për komunat Prizren, Dragash, Suharekë, Rahovec, Malishevë, Mamushë),

Pejë (për komunat Pejë, Istog, Klinë, Deçan, Gjakovë dhe Junik),

Mitrovicë (për komunat Mitrovicë e Jugut, Vushtrri, Skenderaj, Drenas, Zecan, Leposaviq, Zubin Potok, Mitrovicë e Veriut),

Gjilan (për komunat Gjilan, Klokot, Ranillug, Ferizaj, Kacanik, Viti, Novo Bërdë, Kamenicë, Shtërpçë, Hani i Elezit).



TEMAT DHE LIGJËRUESIT:

1. Roli i anëtarit të Kuvendit Komunal / **Agron Maxhuni, MAPL**
2. Infrastruktura ligjore ekzistuese mbi vetëqeverisjen lokale në Kosovë / **Rozafa Ukimeraj, MAPL**
3. Efikasiteti i Punës të Kuvendit Komunal / **Ismet Kryeziu, Instituti Demokratik i Kosovës**
4. Roli i Opozitës dhe Pozitës në Kuvendin Komunal / **Ismet Kryeziu, Instituti Demokratik i Kosovës**
5. Komunikimi, Roli i Shoqërisë civile dhe pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje / **Agron Demi, Instituti GAP**
6. Roli i Asociacionit të Komunave të Kosovës / **Sazan Ibrahim, AKK**
7. Demokracia Lokale - Parimet e Përgjithshme / **Esat Stavileci, Profesor**
8. Vetëqeverisja Lokale dhe Zhvillimi Ekonomik Lokal / **Salvador Elmazi, Profesor**
9. Të drejtat e Njeriut dhe Roli i Institucionit të Ombuds-personit / **Hilmi Jashari, ish-Ombudsperson i Kosovës.**



Shkurtimisht

- Bashkëpunimi në mes AKK-së dhe GiZ/MMS ka sjellë vendimin e GiZ/MMS në mbështetjen e 5 veprimeve nga Strategjia për Kolegjin e Shërbimeve Publike të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Veprimet janë të ndërlidhura me trajnimet për ligjin për mbeturina dhe ndërmarrjet publike dhe përcaktimin e tarifave për mbledhje të mbeturinave. Kolegjiumi i AKK-së për Shërbime Publike është një mekanizëm i përbërë nga të gjithë Drejtorët Komunal për Shërbime Publike.

- AKK-ja po vazhdon me pjesëmarrjen në takimet e rregullta në Këshillin e Turizmit të Kosovës, i cili Këshillë ka hartuar planin e punës për vitin 2014, ku pritet që Komunitat respektivisht drejtoritë apo zyrat për turizëm të kenë përkrahje me shumë tani qoftë institucionale qoftë nga donatorët.

- Po vazhdon konsultimi i zyrtarëve komunal me administratën e AKK-së, lidhur me dhënien e këshillave juridike, dërgimin e informative të ndryshme lidhur me zbatimin e ligjeve, që anëtarët e kuvendeve të komunave, mos t'i mbajnë pozitat e dyfishta, ngase vendimet e atyre kuvende të komunave do të jetë të kundërligjshme.

- AKK-ja ka zhvilluar takimin edhe me ekspertët e FAO-së lidhur me çështjen e pyjeve, ku së shpejti pritet të filloj punën grupi punues për hartimin e Ligjit për Pyje, AKK-ja do të jetë anëtar në grupin punues.

Konstituohen organet e reja të Kolegjiumeve të AKK-së

Asociacioni i Komunave të Kosovës, në kuadër të konstituimit të organeve të reja pas zgjedhjeve lokale, është në fazën e konstituimit të Kolegjiumeve Profesionale.

Në këtë kuadër, janë konstituar Kolegjiumi i Kryesuesve të Kuvendeve Komunale, Kolegjiumi për Planifikim Hapësinor, Kolegjiumi për Shërbime Publike dhe Kolegjiumi për Inspeksionin Komunal, Kolegjiumi për Arsim dhe Kolegjiumi për Buxhet dhe Financa. Në këto takime janë zgjedhur Bordet e Kolegjiumeve si dhe Kryesuesi dhe Zëvendës-kryesuesi i Kolegjiumeve. Ndërkohë takime kanë mbajtur edhe Kolegjiumi i Zyrtarëve Ligjor dhe Kolegjiumi për Integritet Evropian. Në të gjitha këto takime, përveç zgjedhjes së organeve drejtuese, Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z. Sazan Ibrahim ka mbajtur një prezantim lidhur me rëndësinë, rolin dhe funksionimin e AKK-së përmes Kolegjiumeve. Poashtu në këto takime janë aprovuar Rregulloret e Kolegjiumeve si dhe është debatuar agjendave legislative me theks inkorporimin e aktiviteteve të secilit Kolegjium në varësi të temave të linjës. Poashtu takimet dhe konstituimi i Kolegjiumeve me organet e reja udhëheqëse do të vazhdojnë në ditët në vijim edhe për Kolegjiumin për Administratë, Kolegjiumin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Kolegjiumin për Zhvillim Ekonomik Lokal. Pas përfundimit të procesit të konstituimit të organeve të reja të Kolegjiumeve, ato do të vazhdojnë punën sipas Planit dhe Strategjive të tyre.

Konstituohen organet e Kolegjiumit për Arsim

Në mbledhjen e mbajtur me datë 27 shkurt 2014, është bërë konstituimi i Kolegjiumit për Arsim të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Në



këtë takim është bërë edhe zgjedhja e Kryesisë dhe e Kryesuesit të këtij kolegjiumi. Kështu Kryesuese e Kolegjiumit për Arsim të AKK-së është zgjedhur znj. Diana Qarkagjija (Drejtoreshë për Arsim në Komunën e Gjakovës) ndërkohë që Zëvendëskryesues i këtij Kolegjiumi është zgjedhur z. Jashar Lushtaku (Skenderaj). Anëtarë tjerë të Kryesisë shtatë anëtarëshe të Kolegjiumit për Arsim të AKK-së janë zgjedhur edhe z. Dragan Dimitrijeviç (Graçanicë), z. Nexhmi Rudari (Podujevë), z. Muhamet Halili (Ferizaj), z. Agim Shkodra (Kamenicë) dhe z. Sherif Berisha (Suharekë). Në këtë takim është miratuar edhe Rregullorja e punës së Kolegjiumit për Arsim të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Konstituohen organet e Kolegjiut të Kryesuesve të Kuvendeve Komunale



Në një mbledhje të mbajtur me datë 25 shkurt 2014 është bërë konstituimi i Kolegjiut të Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Në takim të Kolegjiut të Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave është bërë zgjedhja e Kryesisë dhe e Kryesuesit të këtij kolegjiu. Kështu Kryesuesi e këtij Kolegjiu të Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave të AKK-së është zgjedhur znj. Valentina Bunjaku-Rexhepi e cila njëherësh është Kryesuesi e Kuvendit të Komunës së Gjilanit ndërkohë që Zëvendëskryesuesi i këtij Kolegjiu është zgjedhur z. Halim Halimi (Prishtinë). Anëtarë tjerë të kryesisë nëntë anëtarësh të Kolegjiut të Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave të AKK-së janë zgjedhur edhe z. Islam Husaj (Pejë), z. Kujtim Gashi (Prizren), z. Bislim Imeri (Mitrovicë), z. Luan Gola (Gjakovë), z. Milazim Haliti (Ferizaj), z. Ismet Salihu (Skenderaj) dhe z. Sasha Aleksiqin (Ranillug). Në këtë takim është miratuar edhe Rregullorja e punës së Kolegjiut të Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Kolegjiu i Zyrtarëve për Integritime Evropiane

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) së bashku me Kryesinë e Kolegjiut për zyrtarë të Integritimeve Evropiane, organizoi takim të rregullt të këtij Kolegjiu me datën 6 shkurt 2014 (e enjte) në Prishtinë. Në këtë takim morën pjesë zyrtarë për integritime evropiane të Komunave të Kosovës, si dhe zyrtarë nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. Takimi u kryesua nga Kryesuesja e Kolegjiut për zyrtarë të integritimeve evropiane znj. Ajshe Bërveniku. Takimi u organizua si vazhdim i takimit nga kryesia e kolegjiut me 28.01.2014 në përgatitjen e planit të punës dhe diskutimin e prioritetëve, si dhe koordinimin e përgjegjësisë në realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të Kolegjiut. Me këtë rast pas shqyrtimit dhe diskutimit të planit të punës për këtë vit kryesuesja hodhi në votim ku edhe mori miratimin nga shu-

Konstituohen organet e Kolegjiut për Buxhet dhe Financa



Në një mbledhje të mbajtur me datë 27 shkurt 2014, është bërë konstituimi i Kolegjiut për Buxhet dhe Financa të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Në këtë takim është bërë edhe zgjedhja e Kryesisë dhe e Kryesuesit të këtij kolegjiu. Kështu Kryesuesi i Kolegjiut për Buxhet dhe Financa të AKK-së është zgjedhur z. Jeton Abazaj (Drejtor për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës) ndërkohë që Zëvendëskryesuesi e këtij Kolegjiu është zgjedhur znj. Zarife Behluli (Obiliq). Anëtarë tjerë të Kryesisë shtatë anëtarësh të Kolegjiut për Buxhet dhe Financa të AKK-së janë zgjedhur edhe z. Slavisha Niçiç (Graçanicë), z. Gani Mustafa (Novobërdë), z. Salih Kqiku (Gjilan), z. Skender Shala (Mamushë) dhe z. Isuf Jashari (Vushtrri). Në këtë takim është miratuar edhe Rregullorja e punës së Kolegjiut për Buxhet dhe financa të Asociacionit të Komunave të Kosovës.



mica e anëtarëve të kolegjiut në përcaktimin e prioritetëve, objektivave, dhe aktiviteteve përcjellëse të Kolegjiut për integritime evropiane.

KONLUZIONET: • Përcjellja e Rregullores nr. 08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrtarëve komunalë për integritim evropian tek kryetarët e komunave të Kosovës nga MAPL-ja. • Shpërndarja e kërkesës për kryetarët e komunave nga ana e AKK-së lidhur me mbështetjen për pjesëmarrje të zyrtarëve komunalë për integritime evropiane në takimet e bordit të drejtorëve.

Shkurtimisht

- AKK-ja është ftuar anëtar në grupin punues për hartimin e "Projektligjit për tregtinë me naftë dhe produkte të naftës".

- Është mbajtur takimi i Kryesisë së Kolegjiut për IT, ku është hartuar drafti i planit të punës së këtij kolegjiut për vitin 2014 me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të sektorit të IT-së në komuna. Krahas kësaj, është përcaktuar edhe data e mbajtjes takimit të Kolegjiut për IT ku do të trajtohet fuqizimi i pozitës së zyrtareve të IT-së në komuna si dhe avancimi i përdorimit të intranetit dhe aplikacioneve të e-Qeverisjes në komuna. Kolegjiut i AKK-së për Teknologji Informative është një mekanizëm i përbërë nga të gjithë Drejtorët Komunal për Shërbime Publike.

- Asociacioni i Komunave të Kosovës ka vazhduar me thellimin e bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare që punojnë në sektorin e qeverisjes lokale në Kosovë. Kështu, me organizatën CDI është diskutuar mbi rolin e Kolegjiut të Shërbimeve Publike të AKK-së në zbatimin e projektit të financuar nga SDC mbi ndërtimin e ujësjellësit dhe kanalizimit në zonat rurale të Kosovës. Ndërsa me Bankën Botërore është diskutuar mundësia e përfshirjes së Kolegjiut për Arsim dhe Kolegjiut për shëndetësi dhe mirëqenie sociale të AKK-së në projektet e Bankës Botërore në sektorët përkatës.

- AKK-ja me mekanizmat e saj po shqyrton Projektligjin për Inspektoratin e Arsimit dhe së shpejti do të del me rekomandime konkrete.

Konstituohen organet e Kolegjiut të Shërbimeve Publike

Në një mbledhje të mbajtur me datë 26 shkurt 2014, është bërë konstituimi i Kolegjiut për Shërbime Publike të



Asociacionit të Komunave të Kosovës. Në takimin e Kolegjiut për Shërbime Publike është bërë zgjedhja e Kryesisë së Kolegjiut. Në këtë takim është bërë edhe zgjedhja e Kryesisë dhe e Kryesuesit të këtij kolegjiut. Kështu Kryesues i Kolegjiut për Shërbime Publike të AKK-së është zgjedhur z. Ukë Selimaj (Drejtor për Shërbime Publike në Komunën e Pejës) ndërkohë që Zëvendëskryesues e këtij Kolegjiut është zgjedhur znj. Hyrije Xhemajli-Thaçi (Drenas). Anëtarë tjerë të kryesisë të Kolegjiut për Shërbime Publike të AKK-së janë zgjedhur edhe z. Aleksandar Mihajloviç (Graçanicë), z. Agim Morina (Mamushë), z. Feim Fetoshi (Rahovec), z. Fatmir Azizi (Ferizaj), z. Ardian Gashi (Prishtinë), z. Blerim Baruti (Mitrovicë) dhe z. Hysen Jerliu (Kamenicë). Në këtë takim është miratuar edhe Rregullorja e punës së Kolegjiut për Shërbime Publike të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Konstituohen organet e Kolegjiut për Inspeksionin Komunal

Në një mbledhje të mbajtur me datë 26 shkurt 2014, është bërë konstituimi i Kolegjiut për Inspeksionin Komunal të



Asociacionit të Komunave të Kosovës. Në këtë takim është bërë edhe zgjedhja e Kryesisë dhe e Kryesuesit të këtij kolegjiut. Kështu Kryesues i Kolegjiut për Inspeksionin Komunal të AKK-së është zgjedhur z. Naim Hajra (Drejtor për Inspeksionin Komunal në Komunën e Mitrovicës së Jugut) ndërkohë që Zëvendëskryesues i këtij Kolegjiut është zgjedhur z. Selver Xhelili (Gjilan). Anëtarë tjerë të kryesisë pesë anëtarëshe të Kolegjiut për Inspeksionin Komunal të AKK-së janë zgjedhur edhe z. Hamdi Jaha (Podujevë), z. Milosh Dimitrijeviç (Graçanicë) dhe z. Kolë Prenaj (Klinë). Në këtë takim është miratuar edhe Rregullorja e punës së Kolegjiut për Inspeksionin Komunal të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Kolegjiumi i Zyrtarëve Ligjor të Komunave të Republikës së Kosovës



Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) organizoi takim e parë të Kolegjiumit të Zyrtarëve Ligjor të Komunave të Republikës së Kosovës të AKK-së, për vitin 2014. Në këtë takim

morën pjesë zyrtarët ligjor të Komunave, Udhëheqësi i Divizionit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal z.Besim Myrtezani, Koordinatori nga GIZ-i z.Driton Vatovci si dhe zyrtarët e AKK-së.

Në këtë takim u diskutua lidhur me Draft-Planin e punës së Kolegjiumit për vitin 2014, diskutim për agjendën legislative për vitin 2014, çështja e stacionit të autobusit rasti i Komunës Vushtrri, si dhe çështja e themelimit të Komunës – Vendimi mbi themelimin- rasti i Komunës së Gjakovës.

KONKLUZIONET:

- Me kërkesë duhet drejtuar Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) - themelimi i Zyrës Ligjore në Komunë;
- U plotësua Plani i punës dhe u miratua plani i punës së KZL-së për vitin 2014;
- Nga Programi Legjislativ i Qeverisë për vitin 2014- përzgjidhen 21 projektligje ku AKK-ja shpreh interesim me qenë e përfshirë në grupet punuese për dhënien e rekomandimeve;
- Vazhdohet me praktikën e shqyrtimit të projektligjeve, kryesia e KZL-së merr pjesë në emër të Kolegjiumit;
- Çështja e stacionit të autobusëve- duhet rregulluar me ligjet e reja në fuqi, Komunitat e pasluftës, nuk marrim përsipër kryerjen e obligimeve të komunave të para luftës, ngase ligji nuk ka karakter retroaktiv;
- Çështja e aktit të themelimit të Komunës- lëshimi i Vendimit për secilën Komunë- me shkresë duhet drejtuar Zyrës së Kryeministrit për mes MAPL-së, për lëshimin këtyre vendimeve për komunitat që nuk i kanë këto vendime.

Shkurtimisht

- AKK-ja respektivisht anëtari i saj në Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare është zgjedhur edhe anëtar në Komisionin të Licencimit (niveli bazik dhe i mesëm) ku ka marrë pjesë në takim e parë të këtij komisioni, ku janë shqyrtuar 20 kërkesa për licencim të ofruesve të shërbimeve sociale, prej të cilave 18 janë licencuar kurse 2 personave do të ju bëhet verifikim i dokumenteve.

- AKK-ja mori pjesë në Grupin Punues për Udhëzim Administrativ (MTI) -nr. 00/2014 për regjistrimin, revokimin e regjistrimit të subjekteve turistike dhe regjistrin e kategorizimeve.

- AKK-ja është emëruar anëtar në Këshillin Organizativ nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) për shënimin e 22 marsit Ditës Botërore të Ujërave dhe 23 marsit ditës Botërore të Meteorologjisë.

Konstituohen organet e Kolegjiumit të Planifikimit Hapësinor

Në një mbledhje të mbajtur me datë 25 shkurt 2014, është bërë konstituimi i Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Në takim e Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor është bërë zgjedhja e Kryesisë. Anëtarë të kryesisë të Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor janë zgjedhur z.Sami Zeka (Drejtor i Urbanizmit në Komunën e Mitrovicës së Jugut), z. Valon Shefkiu (Gjilan), z. Fehmi Hoxha (Rahovec), z. Milutin Popoviç (Ranillug), z. Sali Lajqi (Pejë), z. Faik Grainca (Ferizaj) dhe z. Liburn Aliu (Prishtinë). Anëtarët e Kryesisë së Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor janë dakorduar që në një takim të veçantë gjatë javëve të ardhshme, ku do të ishin prezent të gjitha anëtarët e sapozgjedhur të Kryesisë, të zgjedhet Kryesuesi i Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor. Në këtë takim është miratuar edhe Rregullorja e punës së Kolegjiumit të Kryesuesve të kuvendeve të komunave të Asociacionit të Komunave të Kosovës.



FOTO LAJM



Drejtori ekzekutiv i AKK-së, z. Sazan Ibrahim bënë dorëzimin e certifikatave për zyrtarët e Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA).

Certifikimi i të Zyrarëve Komunal Arsimit - Me 21 Shkurt 2014 në Prishtinë, AKK-ja në mbështetje të Programit GIZ/CDBE dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë/MASHT organizoi ceremoninë e certifikimit të zyrtarëve komunal arsimor DKA-ve, pjesëmarrës në programin trajnues në Menaxhimin e arsimit të zhvilluar gjatë vitit 2013.

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS BULETINI

Viti XI. Nr. 64 • Janar - Shkurt 2014

PËRGATITI:

Arsim Osmani - MENAXHER PËR KOMUNIKIM

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: info@komunat-ks.net

Web: www.komunat-ks.net

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përherëshëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacion i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

